

RAPORT I I AUDITIT TE PAVARUR

NR. 6378/12
U PROTOKOLLUA
NR. 26 PROT. 2012
DATE

Per krijimin e te ardhurave dhe shpenzimet e kryera nga
Partia Ideali Komunist per vitin 2011

Drejtuar Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
Tirane

Zoterinje te nderuar !

Ne ekzekutim te misionit qe me eshte besuar prej jush , kam nderin t'ju paraqes
raportin mbi veprimtarine financiare te Partise Ideali Komunist, gjate vitit 2011.

Partia e Idealit Komunist eshte krijuar me urdher te ministrit te Drejtesise nr. 16/1, date
31.12.1998. Ky urdher u gjet nga ana ime ne arshiven e Gjykates se Rrethit Gjyqesor
Tirane.

Pervec ketij urdheri, nuk ekzistonte asnje e dhene tjeter, per kryetarin e partise, komitetet
drejuese, etj. Ne gjykate nuk kishin asnje informacion tjeter pervec ketij urdheri. Anetaret e
kesaj e kesaj partie sipas listes qe ekzistonte ne gjykate nuk kishin asnje adrese per ti
kontaktuar. Bera kerkim ne drejtorine rajonale tatimore Tirane dhe nuk figuronte e
regjistruar ne sistemin informatik te tyre.

Sic shihet kjo parti eshte de fakto inekzistente.

Si ekspert kontabel I regjistruar propozoj: Fshirjen e kesaj partie nga regjistrat e KQZ-se
dhe te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Kjo situatë kerkon ndryshime te nevojshme ne
legjislacionin perkates kur jane rastet e meposhtme:

- Partite qe nuk kryejne aktivitet , vecanerisht ato qe nuk marrin pjese ne zgjedhje te
pergjithshme ose vendore per nje periudhe prej 5 vjetesh.
- Partite qe nuk kane zbatuar legjislacionin tatimor per regjistrimin si organizata
jofitimprurese per nje periudhe per me shume se nje vit , te kalojne ne regjistrin pasiv te
ketij institucioni dhe te mos jene objekt ne KQZ per tu audituar ose veprime te tjera.
- Duke bere keto ndryshime bejme azhornimin e partive reale te regjistruara dhe qe
kryejne aktivitetin e tyre, pavaresisht nese marrin pjese ne zgjedhje ose jo.

OPINIONI

**Bazuar ne auditimin e kryer , me siguri te arsyeshme , sipas opinionit tim si
audit, partia e Idealit Komunist nuk figuron si parti aktive dhe si e tille nuk ka kryer
veprimtari financiare dhe nuk ka zbatuar kerkesat e ligjeve perkatese.**

Tirane me 15.06. 2012

Audit i Pavarur
Qani Kajo



Adresa: Rruga "Myslym Shyri" Pall. 49/1/3
Tel. 04 2244974 Mob.0692070915
Lic. prof. Nr. 76; Nipt K37810309H